VENDI QË ZË PUNA ME FOLKLORIN NË EDUKIMIN FIZIK TË NXËNËSVE NË ARSIMIN FILLOR

Rriollza AGOLLI
Departamenti i Edukimit
Universiteti "Fan S. Noli"
ragolli@unkorce.edu.al

Eftiona BYLYKBASHI
Specialiste e Botimeve Shkencore
Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakt
Ky studim shqyrton vendin që zë puna me folklorin në edukimin fizik të nxënësve të arsimit fillor, bazuar në perceptimet e 105 mësuesve. Nga një pyetësor më i gjerë, u analizuan katër pyetje specifike mbi disponueshmërinë e burimeve didaktike dhe trajtimin e elementeve tradicionale brenda kurrikulës zyrtare. Rezultatet zbulojnë një diferencë të theksuar midis kërkesave kurrikulare teorike të programit të fushës përkatëse dhe gjetjes përsa u përket teksteve të lëndës: 84.76% e mësuesve (N=89) pranojnë mungesën e tekstit shkollor për lëndën e Edukimit fizik, ndërkohë që vetëm 6.67% raportojnë përdorim të tekstit të miratuar. Në planin pedagogjik, kjo tregon se lënda realizohet kryesisht përmes udhëzimit të drejtpërdrejtë (demonstrim dhe element verbal), në mungesë të mbështetjes tekstuale zyrtare. Nga ana tjetër, analiza e programit zyrtar evidenton se ai ofron një repertor të përcaktuar lojërash dhe aktivitetesh tradicionale, duke e konceptuar edukimin fizik jo thjesht si zhvillim fizik-motorik, por si përvojë me potencial ndërkurrikular, në ndërveprim me kompetenca si komunikimi, të menduarit dhe qytetaria. Në këtë kuadër, lojërat popullore të trajtuara në studim vështrohen edhe në kontekstin e tyre historik, si pjesë e trashëgimisë kulturore shqiptare, duke theksuar se ato përfaqësojnë vetëm një pjesë të repertorit të pasur të traditës sonë, ndërsa për interpretime dhe ilustrime të mëtejshme është shfrytëzuar edhe materiali folklorik i përmbledhur në vëllimin "Lirika popullore" vëllimi 6. Studimi rekomandon pajisjen e mësuesve me tekste shkollore të dedikuara për lëndën e Edukimit fizik, që të mbështesin zbatimin efektiv të elementeve tradicionale e folklorike të parashikuara nga programi.

Fjalë kyçe: *edukim fizik, folklor, lojëra tradicionale, tekst shkollor, kurrikul, arsim fillor*

THE ROLE OF FOLKLORE-BASED ACTIVITIES IN THE PHYSICAL EDUCATION OF PRIMARY SCHOOL STUDENTS

Abstract

This study examines the role of folklore-based activities in the physical education of primary school students, based on the perceptions of 105 teachers. Drawing from a broader questionnaire, the study analyzes four specific questions regarding the availability of instructional resources and the incorporation of traditional elements within the official curriculum. The results reveal a significant discrepancy between the theoretical requirements of the subject area curriculum and the actual findings regarding textbooks: 84.76% of teachers (N=89) acknowledge the absence of a textbook for Physical Education, while only 6.67% report using an approved textbook. From a pedagogical perspective, this indicates that the subject is taught primarily through direct instruction (demonstration and verbal explanation) in the absence of official textbook support. Conversely, an analysis of the official syllabus reveals that it offers a defined repertoire of traditional games and activities, conceptualizing physical education not merely as physical-motor development, but as an experience with cross-curricular potential that interacts with core competencies such as communication and expression, thinking, and civic skills. The study recommends providing teachers with subject-specific textbooks for Physical Education to support the effective implementation of the traditional and folkloric elements outlined in the curriculum.

Keywords: *physical education, folklore, traditional games, textbook, curriculum, primary education*

HYRJE

Zbatimi i *Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar* (MAS, 2014, f. 7–12) ka vendosur në qendër të procesit edukativ zhvillimin e kompetencave kyçe, ku formimi kulturor dhe qytetar konsiderohen shtylla prioritare për ndërtimin e identitetit të nxënësit. Megjithatë, për të siguruar një integrim organik të këtyre vlerave në praktikën shkollore, nevojitet një vëmendje më e shtuar ndaj elementeve të trashëgimisë sonë popullore (Kapidani, 2016, f. 1).

Zbulimi i vetëdijes kulturore jo vetëm që ndikon në sjelljen e dikujt, por mbështetur në një qasje etnopedagogjike është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e kompetencave të individit në fusha të ndryshme të dijes (Rahmawati et al., 2020, p. 663).

Lojërat popullore përfaqësojnë një trashëgimi të çmuar kulturore dhe historike. Praktikohen me kënaqësi nga fëmijët, duke u konsideruar pjesë e veprimtarive kreative të tyre (Addy Putra et al. 2084–89). Këto lojëra mbartin vlera humane dhe kulturore, si dhe shërbejnë si mjet për transmetimin e trashëgimisë popullore nga një brez në tjetrin (Civallero, 2007, pp. 226–28; Akbari, et al. 2009, p. 124).

Në kontekstin shqiptar, proceset e globalizimit dhe digjitalizimit e kanë reduktuar kontaktin e brezit të ri me këtë trashëgimi, duke krijuar një distancë kulturore që arsimi mund ta ekuilibrojë. Një analizë e procesit të qasjes ndaj lojërave popullore në punën me nxënësit në arsimin fillor është e domosdoshme për të bërë vlerësimet përkatëse, si dhe për të dalë me detyra konkrete për praktika aktuale.

Objekti i studimit

Folklori ynë ka luajtur historikisht një rol qendror në konsolidimin e identitetit kulturor. Prandaj, ky kërkim merr përsipër analizën përmbajtësore të integrimit të elementeve folklorike në kurrikulën e "Edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit[1]" në arsimin bazë, duke vlerësuar ndikimin e tyre në formimin kulturor dhe qytetar të nxënësve.

Pyetjet kërkimore

Duke u bazuar në këtë aspekt, kemi parashtruar këto pyetje kërkimore:

1. Si është konceptuar prania dhe integrimi i materialeve të folklorit në përmbajtjen e programit zyrtar për edukimin fizik në arsimin fillor?
2. Në çfarë mënyre ndikon mungesa e tekstit shkollor në zbatimin e qëllimeve didaktike të folklorit në lëndën "Edukim fizik" (klasat I–V), si dhe në realizimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës?

[1] Ky botim përqendrohet në fushën "Edukim fizik, sporte dhe shendet" brenda studimit më të gjerë mbi integrimin e folklorit në arsimin fillor.

Hipotezat e studimit

1. Prania dhe integrimi i materialeve të folklorit në programin e *Edukimit fizik*, të arsimit fillor janë konceptuar në mënyrë progresive, duke filluar me lojërat popullore, bazuar në rregullat e thjeshta që synojnë zhvillimin motorik dhe socializimin, drejt një strukture lojërash më komplekse koordinative dhe ritmike, duke synuar rritjen e krenarisë kombëtare.

2. Zbatimi i qëllimit didaktik të folklorit në *Edukimin fizik* (klasat I–V), në kushtet e mungesës të një teksti shkollor, gjen mbështetjen në përkushtimin pedagogjik të mësuesit për realizimin e kompetencave kyçe dhe të lëndës.

Metodat e kërkimit

Përzgjedhja e metodave të kërkimit mbështetet në objektiva specifike, në qëllimin e tij dhe natyrën e studimit. Kjo mënyrë e ndërthurur rrit saktësinë e të dhënave, si dhe ofron një qasje praktike të drejtuar nga problemi ndaj kërkimit (Denscombe, 2014, p. 160).

Studimi ndjek një dizajn paralel konvergjent (Creswell and Plano Clark, 2011, pp. 7–11), i cili lejon mbledhjen dhe analizën e pavarur të të dhënave sasiore dhe cilësore brenda së njëjtës fazë kohore në mënyrë të pavarur, për t'u integruar më pas në interpretimin të rezultateve. Përshkrimi analitik cilësor i këtij studimi realizohet nëpërmjet hulumtimit të programeve lëndore. Gjatë analizës cilësore të këtyre të dhënave, procesi vijon me përmbajtjen specifike dhe vijon me vendosjen e marrëdhënieve shkakësore, motiveve dhe vlerësimin e veçorive (Braun and Clarke, 2006, p. 79). Procesi nuk është thjesht përshkrues, por reflektues, duke sjellë ndarjen e perspektivave dhe ideve (Calderhead, 1981, pp. 211–17), si dhe duke treguar ndikimin e tij në zhvillimin fizik dhe të menduarit reflektues të nxënësve. Për pyetje të hapura dhe sugjerimet e mësuesve, u përdor metoda e analizës së frekuencës së termave. Përmes gjenerimit të "Resë së fjalëve" (WordCloud), u identifikuan konceptet kryesore dhe shqetësimet më të shprehura nga mësuesit në mënyrë kualitative.

Analiza sasiore e punimit ndjek një qasje analitike, e cila mundëson vlerësimin e perceptimeve të mësuesve në kushtet e mungesës së materialeve didaktike burimore, duke evidentuar qëndrimin ndaj sfidave të integrimit të folklorit.

Kampioni dhe burimet e të dhënave

Për të siguruar një analizë shteruese, dhe për të mundësuar verifikimin e përshtatshmërisë mes kuadrit kurrikular teorik dhe zbatimit të tij praktik, ky studim mbështetet në një proces kampionimi të dyfishtë që përfshin dokumentet zyrtare (Creswell, Educ.) dhe empirike të mëposhtme:

- Programin lëndor të institucioneve përgjegjëse për arsimin — Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS)/Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë (MASR), Ministria e Arsimit (MA) [2] dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për periudhën (2014-2025).
- Pyetësor mbi mungesën e teksteve dhe burimet alternative.

Ky instrument u hartua si një nevojë specifike metodologjike pas konstatimit të mungesës së teksteve zyrtare për lëndët e profileve artistike dhe teknologjike. Qëllimi parësor ishte evidentimi i kësaj mungese burimore dhe identifikimi i mënyrës se si mësuesit i përzgjedhin dhe i integrojnë materialet mbi folklorin në kushtet e mungesës së një teksti bazë[3].

Për hartimin e këtij instrumenti, u mbështetëm në parimet metodologjike të kornizës TALIS[4] — *Anketa Ndërkombëtare e Mësimdhënies dhe të Nxënit* (*Teaching and Learning International Survey*) e cila vlerëson mjedisin e mësimdhënies dhe disponueshmërinë e burimeve kurrikulare. Pyetësori është një përshtatje specifike, e fokusuar në rastin tonë në realitetin e lëndës *Edukim fizik.*

[2] Gjatë periudhës që mbulon ky studim, institucioni përgjegjës për arsimin ka pasur emërtime të ndryshme zyrtare (Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Arsimit). Në këtë punim përdoren emërtimet përkatëse sipas vitit të publikimit të dokumenteve zyrtare të analizuara.

[3] Theksojmë se ky pyetësor është pjesë e studimit të përmendur më lart. Për këtë punim janë trajtuar vetëm pyetjet që lidhen me temën tonë.

[4] TALIS është një anketë ndërkombëtare që bëhet çdo 5–6 vjet nga OECD. Përmes kësaj ankete pyeten mësuesit dhe drejtuesit e shkollave. Qëllimi është të kuptohet se si punojnë mësuesit, çfarë vështirësish kanë dhe si i menaxhojnë klasat. Sipas raportit TALIS, suksesi i zbatimit të kurrikulës varet drejtpërdrejt nga balanca midis autonomisë profesionale të mësuesit dhe disponueshmërisë së burimeve cilësore (*TALIS (II)*, 2018, pp. 25–33). Mungesa e këtyre të fundit i detyron mësuesit të ndërmarrin rolin e hartuesit të materialeve, një proces që kërkon kohë shtesë dhe përfshirje kërkimore jashtë orarit mësimor.

Validiteti i instrumentit u sigurua përmes një studimi pilot me një grup prej 20 mësuesish, proces i cili konfirmoi qartësinë terminologjike dhe përshtatshmërinë e pyetjeve me realitetin e punës në shkollë. Më tej, instrumenti u shpërnda te një kampion prej 105 mësuesish të profileve përkatëse. Ndonëse në sasi të vogël ky kampion ofron një vlefshmëri përmbajtësore, pasi përbëhet nga mësues të klasave të ndryshme.

Nga instrumenti me njëmbëdhjetë pyetje, janë shkëputur gjashtë prej tyre të fokusuara për qëllimin tonë në këto kontekste:

- Profilizimi kontekstual: Të dhënat demografike dhe identifikimi i klasave ku jepet mësim për të vëzhguar shpërndarjen e mungesës së teksteve. Qëllimi ishte të verifikohej nëse kjo mungesë është e njëjtë në klasa të ndryshme.
- Verifikimi i mungesës së teksteve: Kjo është pyetja kryesore që shërben për të evidentuar se lënda nuk ka tekst të miratuar nga MA.
- Burime alternative: Janë pyetje që tregojnë vështirësitë dhe mbështetjen në burimet didaktike për realizimin e programit të lëndës, në mungesë të një teksti zyrtar.

Përpunimi i të dhënave është kryer përmes mjedisit statistikor RStudio, duke përdorur gjuhën programuese R.

Pjesëmarrësit në kërkim: Një nënkampion i fokusuar prej 105 mësuesish të arsimit fillor, për të gjurmuar praktikat didaktike në *Edukimin fizik* ku u konstatua mungesa e teksteve zyrtare për nxënësit.

I. RISHIKIMI I LITERATURËS

Loja përfaqëson një aspekt edukativ me rëndësi të veçantë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës gjatë viteve të para shkollore. Ajo kontribuon jo vetëm në stimulimin e të nxënit, por edhe në formimin e të gjithanshëm të fëmijës, duke luajtur një rol thelbësor në periudhën e arsimit fillor. Aktiviteti fizik i shëndetshëm përmes lojës ndihmon në zhvillimin dhe forcimin e aftësive motorike, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin konjitiv, social dhe emocional të fëmijës (Lavega et al., 2014, p. 458, 464–65; Valentini and Morbidelli, 2017, p. 370).

Lojërat popullore përbëjnë një komponent themelor të edukimit fizik si nga aspekti epistemologjik dhe pedagogjik, ashtu edhe nga ai didaktik. Përveç kësaj, këto lojëra ndikojnë më shumë në zhvillimin e fëmijëve, duke stimuluar socializimin me bashkëmoshatarët, në dallim nga lojërat që promovojnë individualitetin të kohëve moderne apo ato digjitale (Oktavia and Sutapa, 2020, p. 406).

Në arsimin fillor, lojërat popullore i udhëzojnë fëmijët drejt një mënyre të re të të menduarit mbi garën, bashkëpunimin, qasjen e vetes me të tjerët dhe përdorimin e objekteve jo konvencionale të lojës. Nga ana tjetër integrimi i mundshëm midis lojërave tradicionale dhe atyre moderne ofron një burim të pasur njohurish për nxënësit dhe mësuesit (Tan et al., 2020, p. 219).

Lojërat popullore në vendin tonë kanë pasur një përhapje të gjerë dhe një rol të rëndësishëm në formimin e brezave të rinj. Ato nuk përfaqësojnë vetëm një veprimtari argëtuese, por shërbejnë edhe si një mjet edukativ i fuqishëm, duke ndihmuar në zhvillimin e shkathtësisë, shpejtësisë, forcës fizike dhe elasticitetit trupor. Përveç aspektit fizik, lojërat bartin vlera morale si guximi, qëndrueshmëria, disiplina dhe bashkëpunimi, duke kontribuar në edukimin e ndjenjës së përgjegjësisë, solidaritetit dhe dashurisë për atdheun (Bushati, 1978, f. 4–5).

Një veçori e rëndësishme e lojërave popullore është dëshmia që ato ofrojnë për lashtësinë dhe identitetin kulturor të shqiptarëve. Këto lojëra shërbejnë si pikë lidhëse midis brezave dhe si element dallues kombëtar. Sipas studiuesit Mark Tirta, këto veprimtari ndihmojnë në ringjalljen dhe forcimin e ndjenjës së përkatësisë, duke përcjellë vlerat e traditave të lashta që mbijetojnë deri në ditët tona (Tirta, 2011, f. 117).

Zhvillimi i lojërave ka qenë i lidhur ngushtë me mjedisin jetësor i cili ka ofruar kushte të favorshme për këtë veprimtari. Po ashtu, një rol të veçantë kanë luajtur të moshuarit të cilët kanë nxitur dashurinë për lojërat dhe i kanë bërë ato pjesë të pandashme të jetës familjare, krahinore dhe shoqërore. Këto veprimtari kanë sjellë gëzim, bashkëpunim dhe harmoni, duke ndikuar pozitivisht në jetën komunitare (Zheji, 1998, f. 46).

Në arsimin bazë, veçanërisht në arsimin fillor, lojërat popullore kanë zënë një vend të veçantë në programet e edukimit

fizik. Përmbajtja e tyre e thjeshtë, shpesh e ndërtuar mbi elemente gjimnastikore dhe atletikë, i ndihmon fëmijët të zhvillojnë koordinimin motorik, të ruajnë shëndetin dhe të përvetësojnë sjellje sociale pozitive (Bushati, 1978, f. 4–5).

Nga këndvështrimi pedagogjik, roli i mësuesit është thelbësor. Ai përzgjedh lojërat e përshtatshme, shpjegon qartë rregullat dhe siguron pjesëmarrjen e të gjithëve. Loja, kështu, shndërrohet në një proces të strukturuar edukativ që zhvillon shpejtësinë, forcën, këmbënguljen dhe respektin për rregullat, duke nxitur frymën e barazisë dhe bashkëpunimit ndërmjet fëmijëve. Ajo pasuron jetën emocionale të tyre, i bën të guximshëm, i fisnikëron, zhvillon ndjenjën e kënaqësisë, të haresë, të estetikës dhe të optimizmit për veprime të guximshme (Mehmedi, 2021, f. 12).

Përmes lojës, fëmijët mësojnë të pranojnë rregullat e bashkëjetesës, të bashkëpunojnë dhe të ndajnë përgjegjësi në veprimtaritë e përbashkëta. Loja i mëson të tregojnë vendosmëri, vetëbesim dhe tolerancë, duke forcuar lidhjen me familjen, vendlindjen dhe atdheun (Çoçaj, 2012, f. 329).

Nga pikëpamja e organizimit, disa lojëra luhen në mënyrë kolektive, me pjesëmarrjen e të gjithëve pa ndarje në grupe, ndërsa të tjera zhvillohen midis skuadrave ose mes dy lojtarësh. Zhvillimi i tyre është spontan, në lagje dhe hapësira të përbashkëta: oda e shtëpisë, hajati, oborri, sokaku, fusha, bjeshka ose mjedise të tjera natyrore sipas stinës, duke kërkuar respektimin e rregullave të përcaktuara. Shumë prej tyre organizohen në kuadër të ceremonive familjare (Sulejmani, 2008, f. 229).

Autorë të ndryshëm kanë ofruar klasifikime të larmishme për lojërat popullore, duke u bazuar në kritere të ndryshme. Sipas Lecajt ato ndahen sipas funksionit në lojëra për zhvillimin e shkathtësisë, forcës dhe shpejtësisë, lojëra për elasticitet e ekuilibër, si dhe ato me karakter imitues ose kalitës (387 cit. Mehmeti, 2021, f. 23). Përveç faktorëve si stina apo terreni, Çoçaj i kategorizon ato në lojëra të fëmijëve, të barinjve dhe të gazmendeve familjare, duke shtuar se ndarja mund të specifikohet më tej sipas moshës, gjinisë apo numrit të pjesëmarrësve. Edhe pse në treva të ndryshme hasen variante dhe emërtime lokale, ato ndajnë një bazë të përbashkët kulturore (329 cit. Mehmeti, 2021, f. 24). Siç vëren edhe Rugova këto variante të luajtura në të gjitha krahinat pasqyrojnë veçoritë psikologjike dhe

zakonet e çdo zone (14 cit. Mehmeti 24). Kjo pasuri mbetet një element kyç i trashëgimisë sonë dhe një dëshmi e gjallë e kulturës shpirtërore shqiptare (Mehmedi, 24).

Pra, lojërat popullore nuk janë thjesht veprimtari kreative, por një instrument gjithëpërfshirës edukativ. Ato forcojnë aftësitë trupore, promovojnë zhvillimin social dhe moral, ndërsa ruajnë dhe transmetojnë identitetin kulturor dhe vlerat kombëtare. Përmes tyre, fëmijët mësojnë bashkëpunimin, respektimin e rregullave, vetëbesimin dhe tolerancën, duke lidhur edukimin fizik me formimin e karakterit dhe me trashëgiminë kulturore.

ANALIZA E REZULTATEVE

Vendi i folklorit në fushën: Edukim fizik, sporte dhe shëndet

Programi *Edukim fizik, sporte dhe shëndet* zhvillohet përmes lëndës *Edukim fizik,* klasa I–V. Në këtë program përveç elementeve të tjera, zënë vend dhe aktivitete lëvizore të mbështetura në trashëgiminë tonë etnoludike[5], duke ndikuar në zhvillimin motorik të nxënësit.

Në shkallën I, programi i jep prioritet edukimit përmes aktiviteteve fizike në të cilat nxënësi fillon të zbulojë pasurinë e traditës nëpërmjet lojërave popullore që nxisin bashkëpunimin. Gjatë kësaj faze, udhëzohet praktikimi i lojërave tradicionale si: *Macja kapi miun*; *E ka kush e ka; Hapa–dollapa*; *Gjilpëra, peri, nyja*; *Çova një letër mu në postë*. Këto lojëra synojnë jo vetëm zhvillimin motorik, por shërbejnë edhe si mjet për socializimin e nxënësit dhe respektimin e rregullave të lojës në grup.

Në vijim, në shkallën II integrimi i folklorit merr një formë më të strukturuar, duke u lidhur drejtpërdrejt me identitetin kombëtar dhe traditën sportive të mjedisit lokal. Në klasën III, programi parashikon zgjerimin e llojeve të lojërave popullore me elemente më komplekse koordinative, siç janë: *Me të kapërcyeme*; *Rrjeta e peshkatarit*; *Kosorja*. Kjo rritje është e dukshme në klasën IV dhe klasën V ku struktura kurrikulare e orienton nxënësin drejt lëvizjeve

[5] Termi *ludik/e* (nga lat. *ludus* – lojë) i referohet natyrës instinktive dhe krijuese të lojës si mjet thelbësor në procesin e njohjes dhe socializimit të fëmijës. Në pedagogjinë bashkëkohore, aktiviteti ludik konsiderohet si një strategji didaktike që integron argëtimin me mësimnxënien, duke nxitur zhvillimin kognitiv, psikomotor dhe afektiv (Huizinga, 1955, pp. 1–28; Piaget, 1999, pp. 166–88).

më ritmike në grup, duke demonstruar koordinim lëvizor në lojëra si: *Vallja e forcës; Letër në postë*; *Topa djegësi (luftash)*; *Gjuajtja e kalasë.*

Përfshirja e folklorit në kompetencat kyçe

Realizimi i kompetencave kyçe të *Edukimit fizik* fillon që në shkallën I me kompetencën e komunikimit dhe e të shprehurit e cila synon përjetimin emocional. Nxënësi mëson të ndërveprojë me të tjerët gjatë ekzekutimit të lojërave popullore, duke shprehur me fjalë të thjeshta emocionet që i sjell suksesi në lojë apo dëgjimi i muzikës shoqëruese (MAS & IZHA, 2017, f. 6; ASCAP, 2014, f. 6–8). Me kalimin në shkallën II, ky komunikim bëhet më i strukturuar. Nxënësi fillon të përdorë një terminologji më të pasur që buron nga tradita, duke shpjeguar rregullat e lojërave si *Kosorja* apo hapat e valleve popullore (Vallja e forcës).

Për përmbushjen e kompetencës së të menduarit, nxënësi nuk mjaftohet vetëm me pjesëmarrjen, por aftësohet të analizojë strukturën e lojës. Ai fillon të identifikojë veçoritë e lojërave popullore të zonës së tij dhe i krahason ato me traditat e rajoneve të tjera, duke zhvilluar strategji lëvizore që përshtaten me situatat e ndryshme të lojës.

Procesi vijon me formimin e kompetencës qytetare dhe asaj personale ku rritja në moshë sjell një ndërgjegjësim më të lartë për trashëgiminë e përbashkët. Në klasën V nxënësi arrin të vlerësojë lojën dhe vallen popullore si pasuri kombëtare. Ai demonstron tolerancë dhe frymë skuadre, duke kuptuar se respektimi i traditës lëvizore është një mjet për forcimin e bashkëjetesës dhe mbrojtjen e diversitetit kulturor brenda shkollës (MASR & IZHA, 2017, f. 7–11). Në këtë mënyrë, edukimi fizik shndërrohet nga një aktivitet i thjeshtë sportiv në një qasje për të njohur dhe kultivuar identitetin kombëtar.

Përfshirja e folkorit në kompetencat e lëndës

Gjatë ndërtimit të kompetencave të lëndës në edukimin fizik, folklori gjen zbatim praktik. Realizimi i kompetencës për të shfaqur aftësi lëvizore, në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive, në programin e klasës I–II vjen si rezultat i koordinimit të lëvizjeve përmes lojërave popullore me rregulla të thjeshta. Në këtë fazë, nxënësi mëson të përshtatë pozicionin e trupit dhe lëvizjet

koordinatave, duke u argëtuar me lojërat tradicionale gjë që i shërben si bazë për hapat e parë të vallëzimit ritmik (MAS & IZHA, 2017, f. 11; ASCAP, 2014, f. 15–16).

Me kalimin në shkallën II (klasa III–V), ky proces zhvendoset drejt kompetencës së ndërveprimit me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive përmes veprimtarive fizike. Nxënësi nuk ekzekuton thjesht lëvizje, por jep mendime për rrugët në të cilat vallja popullore dhe lojërat tradicionale i japin mundësi shprehjes së kulturës krahinore dhe kombëtare. Gjatë kësaj shkalle ai identifikon veten si pjesë e një komuniteti të caktuar kulturor, duke krahasuar mënyrat se si krahina të ndryshme i interpretojnë elementet e folklorit lëvizor. Kjo realizohet përmes ekzekutimit të lojërave më komplekse, si *Kosorja* apo *Vallja e forcës*, ku kërkohet një nivel më i lartë bashkëpunimi dhe sinkronizimi.

Në vijim, përmes kompetencës përshtatja e një stili jete aktive dhe të shëndetshme, nxënësi fillon të vlerësojë trashëgiminë e lojës dhe valles popullore jo vetëm si argëtim, por si një element formues të identitetit (MASR & IZHA 12–13).

Lënda e *Edukimit fizik* ndërvepron me fushat e tjera për të përforcuar rolin e folklorit si një mjet edukativ dhe kulturor. Ky integrim realizohet natyrshëm me *Artet* ku lëvizjet e koordinuara të valleve popullore sinkronizohen me ritmin dhe muzikën tradicionale, duke i dhënë nxënësit një kuptim më të plotë të shprehjes artistike përmes trupit. Qasja me *Qytetarinë* dhe *Historinë* bëhet e dukshme përmes lojërave popullore të cilat shërbejnë si mjete për të kuptuar evolucionin e shoqërisë dhe rëndësinë e bashkëjetesës paqësore.

Më tej, lidhja me *Gjuhën shqipe* vjen përmes terminologjisë specifike të lojërave dhe tregimeve që shoqërojnë vallet, duke pasuruar fjalorin e nxënësit me terma të traditës. Ky gërshetim ndërkurrikular bën që nxënësi të mos e shohë aktivitetin fizik thjesht si ushtrim, por si një përvojë kuptimplotë që integron shëndetin, historinë dhe identitetin kombëtar.

Analiza e mungesës së teksteve shkollore

Analiza vijuese e këtij seksioni fokusohet te katër pyetje që evidentojnë perceptimin e mësuesve të të gjitha niveleve të arsimit fillor mbi mungesën e teksteve shkollore dhe materialeve didaktike burimore për integrimin e folklorit në edukimin fizik. Në veçanti,

vëmendja përqendrohet te burimet alternative që mësuesit vetë identifikojnë dhe përdorin për ta kompensuar këtë boshllëk, si dhe te ndikimi i kësaj mungese në praktikën e tyre të përditshme mësimdhënieje.




Figura 1. Shpërndarja gjeografike sipas DRAP-it

Analiza e kampionit të studimit, përsa i përket shpërndarjes gjeografike sipas Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), tregon përqendrim më të lartë të mësuesve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në DRAP-in Korçë, me një frekuencë prej 92 pjesëmarrësish (87.62%). Pjesa tjetër e kampionit përbëhet nga mësues të DRAP-it Tiranë (8.57%), DRAP-it Durrës (2.86%) dhe DRAP-it Lezhë (0.95%). Ky variabël i pavarur shërben si bazë për vlerësimin e të dhënave në vijim, duke mundësuar një pasqyrim të sfidave kurrikulare me fokus të veçantë në rajonet ku përfaqësimi është më i lartë, por pa përjashtuar diversitetin e përvojave nga zonat e tjera arsimore të përfshira në kërkim.




Figura 2. Analiza e kampionit sipas nivelit të klasës

Përbërja e kampionit sipas variablit të nivelit të klasës reflekton një përfshirje të gjerë të të gjitha shkallëve të arsimit fillor. Rezultatet pasqyrojnë se 29.52% e pjesëmarrësve ushtrojnë veprimtarinë e tyre në klasat e katërta (IV), ndjekur nga klasat e dyta (II) me 21.9% dhe klasat e treta (III) me 19.05%. Një peshë specifike zënë edhe klasat e pesta (V) me 17.14% dhe klasat e para (I) me 7.62%. Vlen të përmendet edhe prania e mësuesve që punojnë në klasa të bashkuara (I-V), të cilët përbëjnë rreth 4.75% të kampionit. Ky diversitet në nivelet e mësimdhënies mundëson vlerësimin e shkallës së vështirësisë në përzgjedhjen e materialeve folklorike, në raport me moshën e nxënësve dhe specifikat e programit lëndor për çdo nivel.




Figura 3. Mjedisi socio-edukativ

Përsa i përket mjedisit socio-edukativ ku mësuesit ushtrojnë veprimtarinë e tyre, të dhënat pasqyrojnë një shtrirje gjithëpërfshirëse të kampionit në të dyja kategoritë e zonave përkatëse. Mësuesit që punojnë në zona rurale përfaqësojnë 57.14% (60 mësues) të kampionit, ndërsa mësuesit në zona urbane përbëjnë 42.86% (45 mësues) të tij. Ky raport statistikor siguron një bazë të qëndrueshme për krahasimin e sfidave kurrikulave. Ai ndihmon të analizohet se si gjeografia dhe infrastruktura e shkollës ndikojnë në qasjen ndaj folklorit.




Figura 4. Evidentimi i pranisë së tekstit shkollor: Edukim fizik

Të dhënat e rezultateve për lëndën e *Edukimit fizik* konfirmojnë një dikotomi të theksuar midis kërkesave kurrikulare teorike dhe zbatueshmërisë praktike. Një përqindje prej 84.76% (89 mësues) pranojnë mungesën e tekstit shkollor. Në planin pedagogjik, kjo tregon se *Edukimi fizik* realizohet përmes udhëzimit të drejtpërdrejtë, që përmban demonstrimin dhe elementin verbal si elemente parësore. Për përdorimin e tekstit të miratuar, raportojnë 6.67% mësues dhe 8.57% e tyre kanë zgjedhur të mos japin përgjigje.




Figura 5. Burimet, përzgjedhja dhe integrimi i elementeve të folkorit në procesin mësimor

Përsa i përket qasjes ndaj burimeve alternative të dhënat e mbledhura përmes instrumentit kërkimor pasqyrojnë një orientim drejt përzgjedhjes metodologjike, duke bërë që mësuesit të realizojnë programin mësimor, përmes gërshetimit të burimeve të larmishme (digjitale, analoge dhe empirike).

Nga përpunimi statistikor vërehet se kategoria me frekuencën më të lartë (22.86%) i përket kombinimit integral të të gjithë faktorëve: programit zyrtar, librit të mësuesit, kërkimit individual dhe improvizimit. Ky rezultat tregon se në mungesë të tekstit shkollor mësuesit nuk mbështeten në një burim të vetëm, por sigurojnë një sinergji burimesh për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

Një gjetje tjeter është pesha që zë “Kërkimi individual” (YouTube, Google, materiale personale). Nëse analizojmë rastet ku

ky element shfaqet (si i vetëm ose në kombinim), vërejmë se ai është i pranishëm në pjesën më të madhe të përgjigjeve (mbi 70% e kombinimeve). Ky rezultat pasqyron një shkallë të lartë të qytetarisë digjitale te mësuesit dhe një përpjekje për të pasuruar procesin mësimor me materiale autentike dhe multimediale, duke tejkaluar kufizimet e mjeteve tradicionale.

Po ashtu, rezultatet tregojnë se libri i mësuesit mbetet një mjet mbështetës (i pranishëm në tre kombinimet kryesore), por ai rrallëherë përdoret i vetëm (vetëm 5.71%). Kjo sugjeron që mësuesit e shohin librin e mësuesit si një strukturë bazë, të cilën e plotësojnë dhe e përshtasin përmes improvizimit të lirë dhe kërkimit vetjak. Ndërkohë, mbështetja përkatëse vetëm te programi mësimor (5.71%) tregon se mësuesit kanë nevojë për materiale më konkrete, sesa thjesht dokumenti zyrtar i rezultateve të të nxënit.

Nga analiza e kampionit, mund të themi që mësuesi është në rolin e "kuratorit të përmbajtjes". Qasja drejt kombinimeve të shumta tregon për një rritje të ngarkesës jashtëmësimore, pasi mësuesit duhet të investojnë kohë të konsiderueshme për të përzgjedhur dhe përshtatur materiale nga burime heterogjene (YouTube, Google etj.), si dhe për t'i bërë ato të pajtueshme me programin mësimor.

Analiza vizuale e frekuencës së termave konfirmon se procesi mësimor mbi folklorin nuk ndjek një linjë të unifikuar kurrikulare, por mbetet subjekt i preferencave dhe aftësive kërkimore individuale të secilit mësues.

Nevoja për ndërhyrje strukturore përmes teksteve



Figura 6. Analiza e sugjerimeve dhe komenteve cilësore të mësuesve në mungesë të tekstit shkollor

Burimi: Analiza e pyetësorëve N = 105 mësues

Në vijim mësuesve iu kërkua të shprehnin në mënyrë të lirë perceptimet dhe sugjerimet e tyre rreth procesit të mësimdhënies së folklorit. Përmes analizës së "Resë së fjalëve", evidentohet se koncepti qendror që përshkon mendimin e mësuesve është mungesa e materialeve dhe teksteve të miratuara.

Termat si: *vështirëson*, *didaktike* dhe *metodologjike* tregojnë se shqetësimi kryesor nuk lidhet thjesht me informacionin e paplotë, por me ndikimin që ka kjo mungesë në cilësinë e mësimdhënies. Mësuesit referojnë se nevoja për përvoja individuale dhe kërkimi i vazhdueshëm për mjete konkrete krijon një mbingarkesë profesionale. Ky korpus mendimesh kualitative, përforcon nevojën për një ndërhyrje strukturore përmes teksteve, për të lehtësuar procesin e transmetimit të vlerave të trashëgimisë te nxënësit.

Diskutimi i rezultateve

Analiza e programeve zyrtare të edukimit fizik për arsimin fillor tregon praninë e folklorit dhe të lojërave tradicionale në programin e fushës "Edukim fizik, sport dhe shëndet". Në shkallën I (klasat I–II), përfshirja e lojërave të tilla si *"Macja kapi miun"* dhe *"Hapa-dollapa"* shërben si një urë lidhëse ndërmjet zhvillimit motorik dhe proceseve të hershme të socializimit të fëmijëve, përmes respektimit të rregullave të thjeshta dhe ndërveprimit me bashkëmoshatarët. Kjo gjetje përkon me trajtimet në literaturë, të cilat e konsiderojnë lojën tradicionale si një mjet të rëndësishëm për përcjelljen e elementeve kulturore dhe për mbështetjen e proceseve të socializimit gjatë fëmijërisë.

Me kalimin në shkallën II (klasat III–V), programi paraqet një strukturë më të ndërlikuar në aspektin koordinativ dhe ritmik, përmes përfshirjes së lojërave dhe valleve tradicionale, si *"Kosorja"* dhe *"Vallja e forcave"*. Kjo tregon se elementi etnoludik nuk kufizohet vetëm në funksionin argëtues apo motorik të aktivitetit fizik, por mund të shërbejë edhe si një mekanizëm për përcjelljen e trashëgimisë kulturore, forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe zhvillimin e vetëdijes kulturore te nxënësit.

Në këtë kuadër, programi zyrtar ofron një repertor të përcaktuar lojërash dhe aktivitetesh tradicionale, duke krijuar mundësi për ndërthurjen e edukimit fizik me dimensione të tjera të

formimit të nxënësit. Përfshirja e kompetencave kyçe, ndër të cilat komunikimi, të menduarit dhe kompetenca qytetare, tregojnë se edukimi fizik nuk konceptohet vetëm si një proces i zhvillimit fizik e motorik, por edhe si një përvojë me potencial ndërkurrikular, që ndërvepron me fusha të tilla si artet, gjuha, historia dhe qytetaria.

Megjithatë, ekziston një mospërputhje e dukshme ndërmjet parashikimeve të dokumentacionit kurrikular dhe kushteve konkrete të zbatimit të tyre në praktikën shkollore. Ndërsa programet zyrtare parashikojnë përfshirjen e folklorit dhe të lojërave tradicionale në edukimin fizik, rezultatet e këtij studimi dhe përgjigjet e mësuesve evidentojnë mungesën e një teksti shkollor të dedikuar për këtë lëndë në arsimin fillor. Në këtë kontekst, mungesa e një burimi të standardizuar didaktik mund t'ua përcjellë mësuesve përgjegjësinë për përzgjedhjen, përshtatjen dhe organizimin e përmbajtjeve folklorike, duke e bërë realizimin e tyre më të varur nga burimet individuale, përvoja profesionale dhe mundësitë konkrete të secilit mësues. Për rrjedhojë, ekziston rreziku që përmbajtjet folklorike të parashikuara në kurrikul të mos përkthehen në mënyrë të njëtrajtshme në praktikën mësimore dhe që potenciali i tyre për zhvillimin fizik, social dhe kulturor të nxënësve të mbetet pjesërisht i pashfrytëzuar.

Të dhënat empirike evidentojnë gjithashtu se, në kushtet e mungesës së një teksti shkollor të dedikuar, mësuesit mbështeten në një kombinim të burimeve didaktike për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive të edukimit fizik. Nga përpunimi statistikor rezulton se kategoria me frekuencën më të lartë (22.86%) i përket kombinimit të programit zyrtar, librit të mësuesit, kërkimit individual dhe improvizimit. Kjo gjetje sugjeron se mësuesit nuk mbështeten në mënyrë ekskluzive në një burim të vetëm, por ndërthurin burime të ndryshme në përpjekje për të përmbushur rezultatet e të nxënit dhe për të përshtatur përmbajtjet kurrikulare me kushtet konkrete të praktikës mësimore.

Një element veçanërisht i rëndësishëm është pesha që zë kërkimi individual, përmes burimeve të tilla si YouTube, Google dhe materialet personale. Në rastet kur ky element shfaqet, qoftë si burim i vetëm, qoftë në kombinim me burime të tjera, ai është i pranishëm në mbi 70% të kombinimeve të raportuara. Kjo gjetje pasqyron një prirje të theksuar të mësuesve për të kërkuar dhe përzgjedhur në mënyrë të pavarur materiale plotësuese, veçanërisht burime digjitale

dhe multimediale, me synim pasurimin e procesit mësimor. Në këtë kuptim, përdorimi i kërkimit individual mund të interpretohet si një formë përshtatjeje profesionale ndaj kufizimeve të burimeve didaktike të standardizuara, duke u mundësuar mësuesve të plotësojnë mungesën ndërmjet kërkesave të programit dhe materialeve të disponueshme për realizimin e tyre në praktikë.

Përfundime

Analiza e programit zyrtar të fushës "Edukim fizik, sport dhe shëndet" për arsimin fillor, e ndërthurur me të dhënat e mbledhura nga mësuesit, evidenton se folklori dhe veçanërisht lojërat tradicionale zënë një vend të parashikuar në përmbajtjen kurrikulare të edukimit fizik. Përfshirja e tyre nuk paraqitet në mënyrë statike, por zhvillohet në mënyrë progresive përgjatë ciklit fillor, duke filluar nga lojëra me rregulla dhe kërkesa motorike më të thjeshta në shkallën I, drejt veprimtarive më të ndërlikuara në aspektin koordinativ, ritmik dhe social në shkallën II. Në këtë kuptim, folklori në kurrikulën e edukimit fizik tejkalon funksionin e një aktiviteti thjesht rekreativ dhe përfaqëson një mundësi për ndërthurjen e zhvillimit motorik me socializimin, komunikimin, ndërveprimin dhe formimin e vetëdijes kulturore.

Njëkohësisht, gjetjet evidentojnë një mungesë të mbështetjes didaktike për realizimin e tij në praktikë. Megjithëse programi zyrtar parashikon përfshirjen e lojërave dhe veprimtarive tradicionale, mungesa e një teksti shkollor të dedikuar për edukimin fizik në arsimin fillor e bën realizimin e këtyre përmbajtjeve të varur në një masë të konsiderueshme nga burimet alternative dhe nga iniciativa profesionale e mësuesit. Për rrjedhojë, zbatimi i përmbajtjeve folklorike nuk mbështetet mbi një bazë të unifikuar didaktike, por zhvillohet përmes ndërthurjes së programit zyrtar, librit të mësuesit, kërkimit individual, materialeve personale dhe improvizimit.

Të dhënat empirike tregojnë se kjo mungesë nuk ka çuar në braktisjen e përmbajtjeve folklorike, por ka nxitur forma të ndryshme të përshtatjes pedagogjike. Fakti që kombinimi i programit zyrtar, librit të mësuesit, kërkimit individual dhe improvizimit përfaqëson kategorinë me frekuencën më të lartë (22.86%) tregon për një proces të shumëfishtë përzgjedhjeje dhe përshtatjeje të burimeve në funksion të realizimit të veprimtarive mësimore. Në të njëjtën kohë, prania e

kërkimit individual në mbi 70% të kombinimeve të raportuara evidenton rëndësinë e burimeve digjitale dhe të materialeve të siguruara në mënyrë autonome nga mësuesit në plotësimin e nevojave didaktike.

Në këtë perspektivë, mungesa e tekstit shkollor nuk përbën vetëm një mungesë materiale, por shfaqet si një faktor që ndikon në mënyrën e organizimit dhe të ndërmjetësimit pedagogjik të përmbajtjeve folklorike. Përmbushja e rezultateve të të nxënit dhe e kompetencave të parashikuara në kurrikul mbështetet në një masë të rëndësishme në përkushtimin profesional, përvojën dhe aftësinë e mësuesit për të identifikuar, përzgjedhur, përshtatur dhe integruar burime të ndryshme. Kjo gjendje pasqyron një nivel të konsiderueshëm pavarësie pedagogjike, por njëkohësisht evidenton nevojën për një mbështetje më të strukturuar dhe të standardizuar në nivel institucional. Megjithatë përfundimet në lidhje me mungesën e teksteve duhen shprehur si perceptime të mësuesve të kampionit, jo si pasqyrë e sistemit arsimor në tërësi.

Në përfundim, gjetjet e studimit mbështesin të dyja hipotezat e ngritura. Hipoteza e parë gjen mbështetje në analizën e programit zyrtar, e cila evidenton një organizim progresiv të përmbajtjeve folklorike, nga lojërat me kërkesa më të thjeshta motorike dhe sociale drejt veprimtarive më komplekse koordinative dhe ritmike. Hipoteza e dytë mbështetet nga të dhënat e praktikës mësimore, të cilat tregojnë se, në kushtet e mungesës së tekstit shkollor, realizimi i përmbajtjeve folklorike dhe i objektivave të lëndës mbështetet ndjeshëm në iniciativën, përkushtimin dhe përdorimin e kombinuar të burimeve nga ana e mësuesve. Megjithatë, këto gjetje sugjerojnë gjithashtu se mbështetja kryesisht në iniciativën individuale nuk mund të zëvendësojë në mënyrë të qëndrueshme një infrastrukturë të standardizuar didaktike.

Në tërësi, studimi evidenton nevojën për ta konsideruar folklorin në edukimin fizik jo vetëm si një përmbajtje të pranishme në dokumentacionin kurrikular, por si një komponent që kërkon burime të përshtatshme didaktike për t'u realizuar në mënyrë të qëndrueshme, sistematike dhe pedagogjikisht të argumentuar në praktikën shkollore.

Rekomandime

Në bazë të gjetjeve të këtij studimi, rekomandohen disa ndërhyrje në nivel kurrikular, didaktik dhe profesional, me synim forcimin e rolit të folklorit në edukimin fizik dhe krijimin e kushteve më të qëndrueshme për zbatimin e tij në arsimin fillor.

Së pari, rekomandohet hartimi dhe përfshirja e një teksti shkollor dhe/ose një pakete të standardizuar didaktike për edukimin fizik në arsimin fillor, e cila të mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë përmbajtjet e përcaktuara në programin zyrtar. Një material i tillë do të mundësonte sistematizimin e lojërave tradicionale, valleve dhe veprimtarive të tjera folklorike, duke ofruar përshkrime të qarta të veprimtarive, rregulla, objektiva didaktike, udhëzime metodike dhe mënyra të përshtatjes së tyre sipas moshës dhe nivelit të zhvillimit të nxënësve.

Së dyti, rekomandohet që materialet didaktike të ardhshme të mos kufizohen në paraqitjen përshkruese të lojërave tradicionale, por të përcaktojnë qartë lidhjen ndërmjet secilës veprimtari folklorike, rezultateve të të nxënit dhe kompetencave të lëndës e kompetencave kyçe. Një qasje e tillë do ta lehtësonte integrimin e dimensionit motorik, social, kulturor dhe ndërkurrikular të edukimit fizik.

Së treti, duke marrë në konsideratë peshën e konsiderueshme që zë kërkimi individual në praktikën e mësuesve, rekomandohet krijimi i një platforme ose arkive digjitale të institucionalizuar, me materiale të verifikuara dhe pedagogjikisht të përshtatshme për lojërat dhe veprimtaritë tradicionale. Një burim i tillë do të mund të reduktonte varësinë nga kërkimet individuale në burime të pakuruara dhe do t'u ofronte mësuesve materiale të besueshme, të aksesueshme dhe të përshtatshme për përdorim në klasë.

Së katërti, rekomandohet forcimi i zhvillimit profesional të mësuesve përmes trajnimeve dhe udhëzimeve metodike mbi përzgjedhjen, përshtatjen dhe integrimin e lojërave tradicionale në edukimin fizik. Trajnimet mund të fokusohen veçanërisht në mënyrën se si përmbajtjet folklorike mund të përdoren njëkohësisht për zhvillimin e aftësive motorike dhe për realizimin e objektivave sociale, kulturore dhe ndërkurrikulare.

Së pesti, rekomandohet që rishikimi i ardhshëm i programeve dhe materialeve kurrikulare të shoqërohet me një vlerësim më të drejtpërdrejtë të zbatueshmërisë së përmbajtjeve folklorike në kushtet

reale të shkollës. Përfshirja e një veprimtarie në programin zyrtar duhet të shoqërohet me burimet, udhëzimet dhe mjetet e nevojshme për realizimin e saj, në mënyrë që përgjegjësia për përkthimin e kërkesave kurrikulare në praktikë të mos mbështetet kryesisht në nismën individuale të mësuesit.

Së fundi, rekomandohet që folklori të trajtohet si një komponent funksional i edukimit fizik dhe i edukimit kulturor, duke ruajtur karakterin e tij autentik dhe duke e përshtatur njëkohësisht me objektivat bashkëkohore të arsimit fillor. Kjo qasje do të mundësonte që lojërat dhe veprimtaritë tradicionale të mos mbeten vetëm elemente të trashëgimisë kulturore të transmetuara në mënyrë sporadike, por të shndërrohen në përmbajtje pedagogjikisht të strukturuara, të integruara në mënyrë të qëndrueshme në procesin mësimor.

Bibliografia

Addy Putra, M. Z., et al. (2014). Re-creation of Malaysian traditional game namely 'Baling Selipar': A critical review. *International Journal of Science, Environment and Technology, 3*(6), 2084–2089.

Akbari, H., et al. (2009). The effect of traditional games in fundamental motor skill development in 7–9 years-old boys. *Iranian Journal of Pediatrics, 19*(2), 123–129.

Braun, V., & Clarke, V. (2006). Using thematic analysis in psychology. *Qualitative Research in Psychology, 3*(2), 77–101. https://doi.org/10.1191/1478088706qp063oa

Bushati, E. (1978). *Lojërat popullore*. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

Calderhead, J. (1981). Stimulated recall: A method for research on teaching. *British Journal of Educational Psychology, 51*(2), 211–217. https://doi.org/10.1111/j.2044-8279.1981.tb02474.x

Civallero, E. (2007). Traditional games, music and oral tradition: Intangible tools in multicultural libraries. *IFLA Satellite Meeting 2007: Innovative Multicultural Library Services for All*, 226–238.

Creswell, J. W. (2012). *Educational research: Planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research* (4th ed.). Pearson.

Creswell, J. W., & Plano Clark, V. L. (2011). *Designing and conducting mixed methods research* (2nd ed.). SAGE Publications.

Çoçaj, N. (2012). *HASI - Enciklopedi etnokulturore V*. Pavarësia

Denscombe, M. (2014). *The good research guide: For small-scale social research projects* (5th ed.). McGraw-Hill Education.

Huizinga, J. (1955). *Homo ludens: A study of the play-element in culture*. Routledge & Kegan Paul. (Original work published 1938)

Kapidani, S. (2016). Trashëgimia kulturore në arsimin fillor mes metodologjive drama dhe teatri në edukim. *Ditët e Studimeve Shqiptare: Konferencë Shkencore*, 1–10.

Lavega, P., et al. (2014). Relationship between traditional games and the intensity of emotions experienced by participants. *Research Quarterly for Exercise and Sport*, *85*(4), 457–467. https://doi.org/10.1080/02701367.2014.961048

Piaget, J. (1999). *Play, dreams, and imitation in childhood* (C. Gattegno & F. M. Hodgson, Trans.). Taylor & Francis Group. (Original work published 1951)

Mehmedi, N. S. (2021). *Edukimi dhe kalitja (përmes lojërave tradicionale shqiptare)*. Vetëpublikim.

Ministria e Arsimit dhe Sportit. (2014). *Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*. Tiranë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, & Instituti i Zhvillimit të Arsimit. (2017). *Kurrikula e bazuar në kompetenca: Lënda Edukim fizik, sporti dhe shëndeti, Shkalla II, Klasat IV dhe V*.

OECD. (2020). *TALIS 2018 results (Volume II): Teachers and school leaders as valued professionals*. OECD Publishing. https://doi.org/10.1787/19cf08df-en

Oktavia, S. T., & Sutapa, P. (2020). Traditional game based learning model to improve elementary school students' motor abilities. *Proceedings of the 3rd Yogyakarta International Seminar on Health*, 405–411. https://doi.org/10.5220/0009787704050411

Rahmawati, Y., et al. (2020). The integration of ethnopedagogy in science learning to improve student engagement and cultural awareness. *Universal Journal of Educational Research*, *8*(2), 662–671. https://doi.org/10.13189/ujer.2020.080239

Sulejmani, B. (2008). *Lojërat popullore në Sharrin e Tetovës*. Tetovë.

Tan, J. S. Y., et al. (2020). The effect of traditional games and free play on the motor skills of preschool children. *International Journal of Childhood Counselling and Special Education*, *1*(2), 204–223. https://doi.org/10.31559/CCSE2020.1.2.6

Tirta, M. (2011). Komunitarizmi në traditën shqiptare, e tashmja dhe e ardhmja. Në *Tradita etnokulturore dhe bashkëkohësia*. QSA–IAKSA.

Valentini, M., & Morbidelli, V. (2017). Gioco e movimento, stimolatori di apprendimenti in età evolutiva. *Formazione e Insegnamento, 15*(1), 355–371.

Zheji, G. (1998). *Folklori shqiptar*. Argeta LMG.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, *Lirika popullore 6, 1992.*